



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MULI Y. MALLKUÇI
ADRESA NR.5, VASO PASHA, NR.13/1
TEL: 692020292**

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 1899

Nr. koleksioni: 867

Tirane më 12/11/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligi nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligi nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar
- 3.Ligi nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022050370102482607



A2022050370102482607

AKT THEMELIMI & STATUT

I SHOQERISE « PMU ITALIA » shpk, TIRANE

Sot, para meje Noter MULI Y. MALLKUÇI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, VASO PASHA, NR.13/1, u paraqit personalisht:

THEMELUES:

1. Arba Kamberi, atësia Eduart, amësia Fatbardha, shtetase Shqiptare, lindur në Prezë, Tiranë dhe banuuese në Tiranë, me adresë Bcurri, 13/23; Nd. 1836; H. 0; Ap. 018; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 29/07/1996, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032714257 dhe nr. personal J65729062T, .

2. Rigers Dibra, atësia Qezar, amësia Elizabeta, shtetas Italian dhe shqiptar, lindur në Tirane dhe banues me adresë Via Olona 44, Gallarate, Italia, lindur më 30/07/1987, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte nr. personal YA3099972, .

Te cilet ne cilesine e “Ortakëve Themelues”, redaktojne kete Akti Themelimi & Statut, nepermjet te cilit deklarojne se, me vullnet të lire, të plete e të sinqerte dhe inisiativen e lire private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ne Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqerine tregtare, me pernjegjesi të kufizuar, **“PMU ITALIA” shpk, Tirane.**

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **“PMU ITALIA” shpk**, Tirane, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pernjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria **“PMU ITALIA” shpk**, Tirane, eshte një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.


Neni 3

Selia



A2022050370102482607

Shoqeria e ka seline ne: Rruga Eshreh Frasherri, nr. 42 Tirane.



Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria “ **PMU ITALIA** ” shpk do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne fushen shitblerje me shumice dhe pakice, import -eksport te produkteve te kozmetike ne per gjithesi, si dhe ne organizimin zhvillimin e kurseve dhe trajnimeve te ndryshme ne fushen e kozmetikes dh bukurise.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR).

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000Lekë (dhjetemije Lek) dhe eshte i ndare në 2 (kuota) pjesë, vlera nominale e të ciles eshte:

Z. Arba Kamperi, e cila zoteron 1 (nje) kuote, me vlore te per gjithshme 5.000Leke (pesemije), qe perbejne 50% (pesedhjete per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Rigers Dibra, i cili zoteron 1 (nje) kuote, me vlore te per gjithshme 5.000Leke (pesemije), qe perbejne 50% (pesedhjete per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Asamblese se Ortakeve në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përparrë datës së mbledhjes së Asamblese se Ortakeve të thirrur për të marrë vendim rrith këtij projektit.



A2012050370102482607

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 5 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kérkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.



Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se Ortakeve, ato mund te transferohen (tjetersohen) me Kontrate Shitje dhe me Kontrate Dhurimi.

Neni 9

Organ i Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

Asambleja e Ortakeve merr vendim me 51% (pesedhjete e nje) te pjeses te pergjitheshme te ortakeve.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e Ortakeve.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administrimi

Administrator i shoqerise do te jete Zj. Fatbardha Kamberi, lindur me 08.01.1975 ne Tirane, banuese ne Tirane, me Leternjoftim nr.personal H55108034D.

Nr. Cel 0676507498

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise. Afati i administratorit do te jete 5(pese) vjet.

Neni 12



A1022050370102482607

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti I administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rr jedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të jalin pëlgimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortaku i vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket kane të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Ortaket kane të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaket që nuk janë administrator, kane të drejtë në çdo kohë të informohen personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve vendos rr eth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Fq. 4



A2022050370102482607

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku i vetem, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar sic mund të jene :

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura

Fq. 5



A2022050370102482607

me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritetë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj t'ë shoqëritetë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne QKB.

Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe të jetë i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit per QKB, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e

ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita perfundimtare

Ky Akt Themelimi & Statut, u redaktua ne 3 ekzemplare me permnjte dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga ne Ortaket Themelues te shoqerise tregtare "PMU ITALIA" shpk , Tirane.

Fq. 6



A2022050370102482607

Neni 26

Depozitimi

Kete akt –themelimi ta aplikoje per pajisje me NUIS prane Qendres Kombetare te Biznesit, **Av. Elton Bega**, lindur me 21.03.1984, me leternjoftim nr.personal I40321081G, me nr.licence 7916.

Ky Akt Notarial, u redaktua ne 3 ekzemplare me permajtje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket Themelues te shoqerise tregtare "PMU ITALIA" shpk, Tirane, nenshkruehet rregullisht para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Përbrojtjen e të dhënavë personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUESIT


Arba Kamberi

ARBA KAMBERI

10

Rigers Dibra

RIGERS DIBRA



NOTER

MULI Y. MALLKUÇI

